

VENDIM
Nr.443, datë 13.7.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.500, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELIT TË PAGAVE
TË PUNONJËSVE TË AVOKATIT TË POPULLIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1, e përmendur në pikën 1 të vendimin nr.500, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e planifikuara për rritjen e pagave, sipas ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare edhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KLASA	EMERTIMI	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHTESA E POZICIONIT
		<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore per Vjetërsi (SHK)	Shtesa per Kualifikim (SHP)	Shtesa per Pozicion (SHP) leke
I - a	Sekretar i Përgjithshëm	10.050	2%	0	123.000
II - a	Ndihmeskomisioner kategoria e parë	10.050	2%	0	100.500
II - b	Ndihmeskomisioner kategoria e dytë. Drejtor Drejtorie	10.050	2%	0	84.000
III - a	Përgjegjës sektori	10.050	2%	0	65.000
IV - b	Specialist	10.050	2%	0	25.850